



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Kryesuesë e Këshillit Drejtues  
Mr. Sc. Laura Kryeziu

Nr. Prot.: 1770  
Datë: 24/6/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina" e shqyrtoi kërkesën më nr. prot: 5/648 dt: 30.05.2019, të paraqitur nga Edmond Aliaga, shef i Dep, të Matematikës në FSHMN, si dhe prof. dr. Armend Shabani, kryetar i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, me qëllim të mbështetjes financiare të një grupei të studentëve, së bashku me dy mësimdhënës për pjesëmarrje në garën "*International Mathematics Competition for University Students 2019*". Në mbledhjen e mbajtur me datën 20.6.2019 merr këtë:

### V E N D I M


- I. APROVOHET kërkesa me nr. ref: 5/648 dt: 30.05.2019, e paraqitur nga Edmond Aliaga, shef i Dep, të Matematikës në FSHMN, si dhe prof. dr. Armend Shabani, kryetar i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, me qëllim të mbështetjes financiare të një grupei të studentëve, së bashku me dy mësimdhënës për pjesëmarrje në garën "*International Mathematics Competition for University Students 2019*", e cila do të mbahet nga data 28 korrik deri më 03 gusht 2019, në Universitetin Amerikan në Republikën e Bullgarisë.
- II. Pjesëmarrësit nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", përkatësisht nga njësia akademike FSHMN, do të janë në përbërje prej:
  1. Prof. dr. Faton Berisha – mësimdhënës në FSHMN,
  2. Prof. ass. dr. Kajtaz Bllaca – mësimdhënës në FSHMN,
  3. Erion Hamiti – student,
  4. Petrit Avdylaj – student,
  5. Fiton Hoxha – student,
  6. Monika Bunjaku – studente dhe
  7. Albert Hoxha – student.
- III. Të përmendurit në konferencën '*International Mathematics Competition for University Students 2019*' do të marrin pjesë në mesin e shumë universiteteve botërore më prestigjioze si: Universiy of Cambridge, Gottingen Tel Aviv University e të tjera, në të cilën konferencë përfaqësueseve të UP-së do t'u jepet mundësi për rritjen e pranisë së Universitetit të Prishtinës në forumet më të njohura ndërkombëtare, të organizuara nga studentët, posaçërisht në garat e matematikës.
- IV. Të përmendurve si në pikën II të këtij vendimi nga buxheti i Universiteti të Prishtinës do t'u mbulohen shpenzimet e pjesëmarrjes (fee), shpenzimet për sigurimin e vizave dhe sigurimin shëndetësor, shpenzimet e udhëtimit si dhe shpenzime tjera ditore, të gjitha këto deri në vlerë 4.228.00 €.
- V. Udhëtimi do të realizohet në këto data: nisja nga Prishtina bëhet në datën 28 korrik, ndërsa kthimi nga Bullgaria në datën 03 gusht 2019.
- VI. Shërbimi financiar është i obliguar që të sigurojë mjetet e parapara deri në vlerë prej 4.228.00 €, të cilët duhet të arsyetojnë me fatura origjinale, si dhe të implementojë në tërsëi këtë vendim në bazë të dëshmive dhe faturave përkatëse.
- VII. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është edhe kërkesa me nr. ref: 5/648 dt: 30.05.2019
- VIII. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i UP-së, pasi e shqyrtoi kërkesën më nr. ref: 5/648 dt: 30.05.2019, të paraqitur nga Edmond Aliaga, shef i Dep, të Matematikës në FSHMN, si dhe prof. dr. Armend Shabani, kryetar i Shoqatës së Matematikanëve të Kosovës, me qëllim të mbështetjes financiare të një grupi të studentëve, së bashku me dy mësimdhënës, për pjesëmarrje në garën “*International Mathematics Competition for University Students 2019*”, e cila do të mbahet nga data 28 korrik deri më 03 gusht 2019, në Universitetin Amerikan në Republikën e Bullgarisë, e konsideroi të arsyeshme, duke pasur parasysh se Universiteti i Prishtinës do të përfaqësohet nga pjesëmarrësit e lartpërmendur, të cilëve do t'u jepet një mundësi përritjen e pranisë së Universitetit të Prishtinës në forumet më të njoitura ndërkombëtare të organizuara nga studentët, ku po ashtu do të fitojnë dije dhe shkathtësi në fushën e matematikës, duke ditur rëndësinë se në këtë garë marrin pjesë edhe shumë universiteteve botërore më prestigjioze si: Universiy of Cambridge, Gottingen Tel Aviv University e të tjera. Prandaj, nga ajo që u tha më lart dhe mbi këtë bazë, u vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Ky vendim t'u dorëzohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Parashtruesit të kërkesës;
3. Dekanit të FSHMN-së;
4. Shërbimit finansiar të UP-së;
5. Zyrës Ligjore të UP-së,
6. Asistentes së KD-së,
7. Ueb-faqes së UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. sc. Laura Kryeziu - kryesuese